

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ORIEL SH.P.K.

NENI 1
FORMIMI

Sot ne dt. 23/05/2024, themelohet ne perputhje me Ligjin 9901, date 14/04/2008 Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare, shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **ORIEL SH.P.K.**. Kjo shoqeri krijohet nga: **IRIS CEKANI** e bija e Fatmir, datelindja 22/07/1972, lindur ne Tirane, Shqiperi, banuese ne Rruga 4 Deshmoret Nr. 199 Tirane, me numer identifikimi H25722147R, madhore dhe me zotesi te pote juridike per te vepruar.

Organ i administrues i Shoqerise ka te drejte te hape ose te mbylle dege dhe/ose zyra perfaqesimi ne Shqiperi dhe jashte saj.

NENI 2
SELIA

Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **ORIEL SH.P.K.** do te jetë ne adresen: Rruga Bardhyl, P. Progeen 2, Tirane 1015, Shqiperi.

Ortaket mund te vendosin per transferimin e selise se Shoqerise ne nje adrese tjeter.


NENI 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **ORIEL SH.P.K.** eshte per nje periudhe pa afat .

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise **ORIEL SH.P.K.** do te jetë:

- A) Aktivitet në fushën e shërbimeve studentore për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ofrimin e shërbimeve të konsulencës, ekspertizës dhe asistencës në hartimin e dokumentacionit, realizimin e aplikimeve për studime universitare në ciklin e parë të studimeve, trajnime, preqatitje kurrikulare jashte shkollore/akademike, studime të nivelit Master, Doktoraturë dhe post-Doktoraturë në universitetet në SHBA, Europë, Kanada, Australi.
- B) Ofrimin e shërbimeve të konsulencës, ekspertizës dhe asistencës në hartimin e dokumentacionit, realizimin e aplikimeve në programet “Training & Internship” në SHBA dhe Europë. Asistencë dhe ekspertizë në hartimin e projekteve kërkimore-shkencore, mbikqyrje dhe konsulencë në përdorimin dhe mënyrën e prezantimit të rezultateve të kërkimit.
- C) Ofrimin e shërbimeve të konsulencës, ekspertizës dhe asistencës në institucionet të cilat mbështesin me bursë studentore. Mbështetje në hartimin e dokumentacionit dhe aplikimin për



pajisje me viza studentore dhe mbështetje për studentët deri në sistemimin e tyre në institucionet pritëse.

- D) Të organizojë trajnime dhe aktivitete promovuese për ndërlidhjen e studentëve me universitetet dhe rritjen e mundësive të tyre për gjithëpërfshirje në rrjetet universitare dhe ato të kërkuesve shkencor.
- E) Të organizojë trajnime dhe aktivitete promovuese për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të të rinjve në tregun e punës. Hartim, publikim dhe monitorim I fushatave të promovimit online të aktiviteteve mbështetëse për studentët dhe të rinjtë.
- F) Konsulencë ne dixhitalizimin e sektorëve të ofrimit të shërbimeve studentore. Shoqëria mund të kryejë cfarëdo lloj shërbimi që paraqitet në pajtueshmëri me objektin e saj dhe që është i lidhur me këtë objekt, duke përashtuar ato shërbime apo veprimitari që vijnë në kundërshtim me rendin publik dhe shtetin e së drejtës.
- G) Shoqeria per perm bushjen e qellimit te saj mund te lidhe marredhenie nenkontraktuale me shoqeri apo persona te trete.
- H) Te aplikojë per marrjen e licencave te ndryshme per te kryer sa me mire dhe me transparente veprimtarine e saj.
- I) Shoqeria, mund te hape dege te saj ne te gjithe boten, duke patur parasysh legjislacionin ne fuqi te Rep. se Shqiperise dhe te vendit ku do te operoje.
- J) Shoqeria mund te angazhohet gjithashtu ne cfaredo lloj aktiviteti tjeter qe nuk ndalohet me ligi brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise.

Me qellim kryerjen e aktiviteteve te mesiperme, Shoqeria mund te ushtroje veprimtarine e saj ne Shqiperi dhe jashte saj e te kryeje çdo aktivitet tjeter te lidhur, ndihmes, te ngjashem, plotesues apo te dobishem per perm bushjen e objektit te saj. Per perm bushjen e objektit te saj, Shoqeria mund te:

- A) Te zoteroje direkt ose indirekt pjesemarrje ne shoqeri dhe/ose sipermarrje te tjera, shqiptare apo te huaja qe kryejne aktivitete te njejta, te ngjashme apo te lidhura me aktivitetin e saj ose qe mund te ndihmojne ne realizimin e objektit te Shoqerise;
- B) Te themeloje dege, zyra perfaqesimi dhe ne per gjithesi te kryeje çdo aktivitet tjeter qe nuk eshte i ndaluar nga ligji.

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise **ORIEL SH.P.K.** eshte 100.000 (dhjete mijë) Leke, ku ortaku **IRIS CEKANI** zoteron 1 (nje) kuote, te barazvlefeshme me 100% te kapitalit themeltar.

Ky kapital eshte i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

Kuotat e Ortakeve regjistrohen ne librin e regjistrimit te kapitalit te shoqerise.

NENI 6

ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese te shoqerise **ORIEL SH.P.K.** jane:

- Asambleja e Ortakeve, organi me i larte vendim-marres.
- Administratori i shoqerise, i cili eshte **SKERDI SULOVARI**



NENI 7

Te drejtat dhe detyrat e Asamblese, organizimi i shoqerise, marredheniet me persona fizike e juridike, vendas apo te huaj shprehen ne statut i cili se bashku me aktin e themelimit perbejne dokumentat baze te veprimtarise dhe sherbejne per zhvillimin e mardhenieve ne kete shoqeri.

NENI 8

Veprimtarine e saj shoqeria do ta zhvilloje ne perputhje me Ligjin 9901, date 14/04/2008 Per tregtaret dhe shoquerite Tregtare, si dhe ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

NENI 9

Te gjitha mosmarrveshjet me persona fizike ose juridike si dhe me organet shteterore, zgjidhen me mirekuptim me ane te dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur keto mjetet nuk jepin rezultat, atehere zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky Akt Themelimi hyn ne fuqi diten e regjistrimit te shoqerise me perjegjesi te kufizuar **ORIEL SH.P.K..** Ne kete dite shoqeria **ORIEL SH.P.K.** njihet si person juridik.

**ORTAKU
I SHOQERISE ORIEL SH.P.K.**

IRIS CEKANI

